



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



11.nr./ 3812 /2025

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIMIT RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës Hani i Elezit në përkrahje të zhvillimit të bletarisë për vitin 2025 do të realizoj projektin : **Subvencionimi i bletarëve me pajisje për bletë.**

Projekti i subvencionimit të fermerëve me pajisje për bletë do të realizohet me bashkëfinancim nga Komuna dhe fermerëve - 20% .

Fermerët mund të aplikojnë për njërin nga këto pajisje :

- Centrifug elektrike 4 kornizëshe dhe
- Pajisje mbrojtëse të bletishteve nga kafshët e egra

Përfitues do të jenë fermerët /bletarët që i plotësojnë këto kritere :

1. Të jetë banor i Komunës Hani i Elezit.
2. Bletishtja të jetë në territorin e Komunës së Hani të Elezit.
3. Bletishtja të ketë mbi 30 koshere me bletë.

Dokumentacioni nevojshëm për aplikim :

- Fletëaplikacioni i plotësuar për aplikim / që merret në Zyrën Pritëse,
- Kopjen e dokumentit identifikues.
- Certifikata e pronës ku ndodhet bletishtja
- Fermerët mund të jenë përfitues vetëm për një bletishte


Përparësi kanë fermerët që nuk kanë qenë përfitues të subvencioneve Komunale tri vitet e fundit.

Të interesuarit për më shumë informata për aplikim mund të drejtohen në zyrën e DBPZHR-së, në objektin e komunës.

Afati për aplikim fillon nga data **27.05.2025** deri më **13.06.2025**.

Data: 27.05.2025

Hani i Elezit



Drejtori i DBPZHR-së
Abduraman Bushi